

**RELACION
PËR PROJEKT-VENDIMIN
“MBI INFRASTRUKTURËN E BRENDSHME PËR RRJETET E
KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE ME SHPEJTËSI TË LARTË DHE
ADMINISTRIMIN E PIKËS SË AKSESIT NË GODINË”**

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Projekt-vendimi “Mbi përcaktimin e rregullave dhe kërkesave për infrastrukturën e brendshme të godinave dhe të administrimit të pikës së aksesit në godinë për rrjetet e komunikimeve elektronike” është propozim i Ministrit për Infrastrukturen dhe Energjinë, në përputhje me pikën 4 të nenit 20, të Ligjit Nr. 120/2016 “Për zhvillimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike të shpejtësisë së lartë dhe sigurimin e së drejtës së kalimit”. Ky projekt-vendim përcakton rregullat dhe kërkesat për infrastrukturën e brendshme fizike të godinave të gatshme për komunikime elektronike me shpejtësi të lartë deri në pikën fundore dhe të administrimit të pikës së aksesit në godinë.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Projekt-vendimi ka qenë parashikuar në programin analitik të akteve për vitin 2018 dhe vjen si nevojë e plotësisimit të kuadrit nënligjor, në zbatim të ligjit Nr. 120/2016 “Për zhvillimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike me shpejtësi të lartë dhe sigurimin e të drejtës së kalimit”.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Ligji Nr. 120/2016 “Për zhvillimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike me shpejtësi të lartë dhe sigurimin e të drejtës së kalimit”, në pikën 4, të nenit 20 ka parashikuar në vija të përgjithshme, rregullat dhe kërkesat për infrastrukturën e brendshme fizike të godinave për komunikime elektronike me shpejtësi të lartë deri në pikën fundore dhe administrimin e pikës së aksesit në godinë për rrjetet e komunikimeve elektronike. Këto rregulla do të zbatohen për çdo godinë të re si dhe, gradualisht për ndërtesat ekzistuese, kur ato janë objekt i punimeve të rikonstruksionit, riparimeve apo rindërtimit dhe punimeve rinovuese të mëdha. Gjithashtu projektvendimi adreson një problematikë lidhur me të drejtën e çdo përdoruesi fundor për të përzgjedhur ofruesin e rrjeteve dhe shërbimeve të

Relacion shpjegues për Projekt-vendimin “Mbi përcaktimin e rregullave dhe kërkesave për infrastrukturën e brendshme të godinave dhe të administrimit të pikës së aksesit në godinë për rrjetet e komunikimeve elektronike”.

komunikimeve elektronike. Zhvillimet e vrullshme të teknologjisë së informacionit, kërkesa në rritje për komunikime elektronike të shpejtësisë së lartë, broadband, e bëjnë të domosdoshme që godinat e reja të kenë të instaluar rrjete që mundësojnë broadband, lidhje interneti me shpejtësi të lartë dhe shumë të lartë, bazuar në të gjitha teknologjitë.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projekt-vendimi është hartuar në mbështetje të nenin 100 të Kushtetutës, pika 2 dhe të nenin 20, pika 4 e Ligjit Nr. 120/2016 *“Për zhvillimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike të shpejtësisë së lartë dhe sigurimin e së drejtës së kalimit”*.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE (PËR PROJEKTAKET NORMATIVE)

Projekt-vendimi nuk transpozon ndonjë akt të veçantë të acquis të BE-së.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektvendimi synon miratimin e rregullave dhe kërkesave teknike për infrastrukturën e brendshme të godinave dhe të administrimit të pikës së aksesit në godinë për rrjetet e komunikimeve elektronike që përfshijnë 39 pika, ku përcaktohen ndër të tjera:

- rregullat dhe kërkesat për infrastrukturën e brendshme fizike të gatshme për komunikime me shpejtësi të lartë deri në pikën fundore, për instalimin e rrjetit kabllor (bakër, fibër optike, kabëll koaksial etj.), i cili mundëson shpërndarjen e shërbimeve broadband me shpejtësi mbi 30 Mbps;
- rregullat që duhet të zbatojnë ofruesit e rrjeteve dhe shërbimeve publike të komunikimeve elektronike me qëllim ndërtimin e rrjetit të tyre deri në pikën fundore;
- administrimi i pikës së aksesit në godinë, i cili do të kryhet sipas dispozitave të legjislacionit në fuqi për administrimin e bashkëpronësisë në ndërtesat e banimit etj.

Përsa i përket specifikimeve teknike për dimensionin e tubacioneve, rrjeteve kablore dhe kasetat e pikës së aksesit në godinë, ato do të miratohen me rregullore nga Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare.

Me anë të këtyre rregullave synohet të adresohen disa problematika ekzistuese në tregun e komunikimeve elektronike që janë vërejtur pas hapjes së tregut të komunikimeve elektronike dhe zhvillimeve teknologjike në veçanti:

- përmes krijimit të pikave të aksesit në godinë mundësojmë ofirmin e disa teknologjive për lidhje përfshirë fibren optike, kabllot koaksiale etj. duke bërë që gradualisht të eliminohen kabllot ajrore në hyrje të godinave;
- përdoruesve do t'u ofrohen disa mundësi lidhjeje për shërbimet e komunikimeve të shpejtësisë së lartë dhe të së ardhmes;
- synohet të garantohet akses i barabartë për operatorët e tregut dhe të shmangen praktikat diskriminuese për aksesin në pikën e lidhjes së rrjeteve në godinat e reja shumëkatëshe, shumë përdorimëshe;
- qartësohen procedurat e ankimimit në rast mosdhënie aksesi, pengesash nga administratorët e godinave etj.

Këto rregulla propozohen të jenë normë e detyrueshme teknike për rrjetet e brendshme të komunikimeve elektronike në godina, referuar përcaktimeve për këtë qëllim në ligjin “Për administrimin e bashkëpronësisë në ndërtesat e banimit” ku në pikën 15 të nenit 2 përcaktohet se: *“Norma detyruese” janë normat për mbrojtjen kundër zjarrit, normat higjieno-shëndetësore, normat për mirëmbajtjen e ashensorëve, si dhe çdo normë tjetër, që ka lidhje me qëndrueshmërinë fizike të objektit, sigurinë e jetesës, të shëndetit publik dhe etikës së bashkëjetesës, të miratuara me ligje të veçanta ose me akte nënligjore, si dhe normat që miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave, në zbatim të këtij ligji”.*

Ky përcaktim është i domosdoshëm duke pasur parasysh rëndësinë që kanë në ditët e sotme rrjetet e komunikimeve elektronike ku nuk përfshijnë më thjesht lidhjen telefonike fikse sikurse shpesh referohet në legjislacion. Rrjetet e komunikimeve elektronike të shpejtësisë së lartë të mundësuar me fiber optike, rrjete koaksiale apo të tjera janë pjesë e rëndësishme e utiliteteve me një rëndësi në rritje krahas rrjeteve të tjera si ato të energjisë, ujesjellesit etj.

Në fund të rregullave si referencë për projektimin, ndërtimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike në godina janë dhënë në një tabelë standardet e harmonizuara shqiptare.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Institucionet që ngarkohet për zbatimin e këtij projekt-vendimi janë autoritetet planifikuese vendore, Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare dhe ofruesit e rrjeteve dhe shërbimeve publike të komunikimeve elektronike.

VIII. MINISTRITË, INSTITUCIONET DHE SUBJEKTET E TJERA QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Projekt-vendimi është hartuar nga stafi i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë në koordinim me Autoritetin e Komunikimeve Elektronike dhe Postare si dhe mbi bazën e disa konsultimeve të kryera me operatorët e telekomunikacioneve me përfaqësues të bashkive etj.

Projekt-vendimi është konsultuar gjatë vitit të kaluar me ekspertët e WBIF që kanë asistuar Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për kryerjen e studimit të fizibilitetit për zhvillimin e broadbandit rajonal, të cilët kanë dhënë disa rekomandime që janë konsideruar në variantin që po përcillet për mendim.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Projekt-vendimi nuk ka ndikim në të ardhurat dhe shpenzimet e buxhetit të shtetit.

MINISTRI

BELINDA BALLUKU